

OMBRA GVG
— MODERNĚ KLASIKĚ —

DINO BUZZATI

KRYEVEPRAT

© 2005 Arnoldo Mondadori S.p.A. Milano
© 2009 - Shtëpia e librit OMBRA GVG Tiranë

Të gjitha të drejtat në gjuhën shqipe janë të rezervuara.
Asnjë vepër apo fragment nuk mund të botohen, fotokopjohen,
apo të kopjohen në formë elektronike e të përdoren për interesat e të dytëve
pa marrë lejen me shkrim nga mbajtësi i të drejtave.

Dino Buzzati
Kryeveprat
Titulli i origjinalit
Dino Buzzati
I capolavori
Arnoldo Mondadori S.p.A. Milano
Botoi
Shtëpia e librit OMBRA GVG Tiranë
Struktura grafike dhe ballina u realizuan
mvsdesign
isbn 978-99956-38-56-6

DINO BUZZATI
Kryeveprat



OMBRA GVG

mvsdesign10

NJË DASHURI

Titulli i originalit:
UN AMORE

Përktheu:
DRITAN ÇELA

Një mëngjes shkurti 1960, në Milano, arkitekti 49 vjeçar Antonio Dorigo i telefonoi zonjës Ermelina.

“Tonino jam, mirëdita zo...”

“Ah, ju qenkeni? U bë kaq kohë që s’jeni dukur këtej. Si jeni?”

“Jo keq, faleminderit. Këto kohë kam qenë deri në fyt me punë dhe kështu... dëgjoni, a mund të vij sot pasdite?”

“Sot pasdite? Pa dale ta mendoj... në ç’orë?”

“Nuk e di. Në tre, tre e gjysmë.”

“Epo mirë, në tre e gjysmë.”

“Ah, dëgjoni, zonjë...”

“Urdhëroni, urdhëroni.”

“Herën e fundit, a ju kujtohet?... me një fjalë, për të qenë i sigurtë, ajo coha nuk më pëlqeu dhe aq, do të doja...”

“E kuptoj. Mjerisht, nganjëherë edhe unë vetë...”

“Diçka më moderne, nuk di a më kuptoni?”

“Po, po. Dëgjoni, bëtë mirë që më telefonuat sot, kemi një rast... pra, do të shihni po nuk ngelët i kënaqur.”

“Stof i zi po qe e mundur.”

“E di, i zi si qymyri.”

“Faleminderit, do të shihemi atëherë.”

Uli telefonin. Ishte fillikat në studio. Edhe Gaetano Maroni, kolegu me zyrën përbri, atë mëngjes kishte dalë.

Ishte një mëngjes dosido i një dite dosido. Punët shkonin fjollë. Nga dritarja e madhe e katit të tretë dukej ngrehina kundruall, një pallat modern krejt i njëjlojtë me pallatet përreth, i njëjlojtë me pallatin ku gjendej Dorigo. Tepër i hareshëm gjithsesi, aty në rrugën Moskova, një varg i gjerë pallatesh i përshkuar nga shëtitore e lulishte ku mund të parkoheshin makinat.

Ishte një prej ditëve të shumta gri të Milanos, porse pa shi, me atë qiell të pakuptueshëm ku s'merrej vesh në ishin re ato aty a vetëm mjegull, përtej së cilës ndoshta fshihej dielli. Apo thjesht blozë që dilte nga oxhakët, nga shfryrëset e kaldajave me naftë, nga tymtarët e rafinerive Koloradi, nga kamionët zhauritës, nga pusetat, nga pirgjet me gërmadha të hedhura në zonat në ndërtim të rrethinës, nga trakeja e miliona e miliona njerëzve - vallë kaq shumë ishin - të grumbulluar në çimento, asfalt e zemërim përreth tij.

Ndezi cigaren e tretë, ora ishte dhjetë e treçerek ("Tonino jam, mirëdita zo..." "Ju qenkeni? U bë kaq kohë që..."), përballë tij ora elektrike që e merrte rrymën nga pallati, kur e kur një grimë e mekët muzike, matanë, në dhomën përbri, zonjusha Maria Torri mbante ndezur mbi tryezë, apo te çanta, apo në prehër, radion e vockël japoneze që s'pushonte kurrë, as edhe gjatë bisedave dhe Dorigos nuk i kishte bërë zemra t'ia ndalonte, fundja edhe ai do ta kishte mbajtur me qejf një të tillë, madje e kishte blerë për dhjetë mijë lira një prej atyre që i sjellin kontrabandë, nga ato që mbahen në xhep, te dyqanet në qendër i shisnin njëzet e katër-njëzet e pesë mijë lira, por s'kishin kaluar as edhe dy ditë dhe ia kishte përllarë Xhorxhina, jo se ndiente kushedi çfarë për Xhorxhinën, por njiheshin prej kaheri, ai e kish hasur nën portikët e Korsos, teksa nga xhepi i dilte një vals vienez, tëpërkë prej asi valsesh që ai s'i honepste dot, por kishte përtuar ta shuante e atëherë ajo kish thënë: "Pa dale ta shoh, sa e bukur, a ma fal mua?". E tekefundit, ç'i bëhej vonë atij për radion?

Ndezi cigaren e katërt, duhej mbaruar një punë, por nuk kishte pikë dëshire, fundja nuk ishte me ngut, mjaft ta paraqiste të shtunën, kurse sot ishte ende e martë, mandej, kur i ngrihej mendja për të bërë dashuri, e kishte shumë të vështirë të punonte. Jo se Dorigo ishte një nga ata tipat që u vlon gjaku e u gurrfullon burrëria gjer edhe nga porët, megjithatë, herë pas here krejt befas, pa shkaqe të dukshme, fantazia vihej në punë dhe e tërë rrjedha e mendimeve ndërronte krejtësisht.

Kur mandej takimi me një vajzë ishte mblesur, i tërë trupi

vihej në pritje, ishte një gjendje plot dhimbje, por njëherësh tejet e bukur, e vështirë për t'u shpjeguar, pothuajse ndjesia e të qenit një viktimë që i blatohej krejtësisht flijimit, me trupin kokë e këmbë lakuriq, me braktisje dhe grafullim energjish shkallmuese, të cilat i ngjethnin çdo pjesë të gjymtyrëve, të rropullive e të mishit. Një yrysh fuqie e llahtarshme, aspak shtazarake dhe e verbër, madje lirike dhe plot ndyrësi të errëta.

Gjatë këtyre orëve Dorigo harronte edhe fytyrën e vet që asnjëherë s'i kishte pëlqyer, që gjithnjë e kishte quajtur të urryer; dhe e gënjente mendja gjer aty, sa t'i dukej vetja i dëshiruar prej grave.

Në të njëjtën kohë, prita e femrës ("Tonino jam, mirëdita zo..." "Ah, ju qenkeni? U bë kohë që...") e bënte të humbte çdo lloj sigurie në vetvete, çka në punë ishte aq e madhe. Përballë femrës nuk ishte më artisti tashmë thuajse i shquar, i përmendur botërisht, skenografi gjenial, personaliteti i zilepsur prej të tjerëve, burri menjëherë simpatik, ai vetë mrekullohej që dukej simpatik aq rrufeshëm, ama me gratë ishte krejt ndryshe, ai kthehej në një dosido, jo tërheqës madje, e kishtë vënë re sa e sa herë, gratë ngeleshin të druajtura dhe sa më shumë rrekej të hiqej i çlirët e hokatar, aq më keq ishte, femra e vështronte e çorientuar dhe mend e trembur, duhej një afrimitet i madh që ai ta merrte veten e të tregohej i natyrshëm, por për të arritur në një afrimitet të mirëfilltë, lipsej njëfarë kohe, fillimi ishte gjithnjë i zorshëm e i stisur, sa zili e kishte Maronin që, me të shkëmbyer dy-tri fjalë, i bënte vajzat të ndiheshin rehat, ndonjëherë gjer edhe e urrente nga nakari, me gratë paradokset e tij të parapëlqyera ishin një lojë kryekëput e gabuar, e kuptonte fare mirë, në vend që t'u sillnin gaz e hare, i çoroditnin dhe i bënin të ndiheshin si mbi gjemba, u linin përshtypjen sikur donte të tallej me to a të mos i përfillte. Ngushëllohej disi me mendimin që klasi i tij arrinte thuajse gjithnjë ta nxirrte nga balta, së paku e bënte të dukej për të qenë, në mos të pëlqehej; femra në fakt e kuptonte qoftë

dhe duke e urryer epërsinë e tij intelektuale, të mbyllur dhe krenare, që nuk arrinte të shfaqej haptazi e, megjithatë, sa do të kishte dashur ai që përkundrazi të lëshohej hareshëm dhe pa vetëpërbajtje, si një fëmijë në entuziazmin e lojës!

Ç'vajzë i kishte përgatitur atë pasdite zonja Ermelina? E ruante veten nga optimizmi i tepërt, sa e vështirë është të gjesh tipin tënd, një gjë ishte e sigurt, falë Zotit, te zonja Ermelina kishte gjithnjë ca vasha të freskëta, në mos tjetër për njomësinë e shtatit të tyre.

Fundja, mendonte, nëse Ermelina i kishte sjellë Britën, nuk do të ishte keq. Kishte muaj që s'bënte dashuri me Britën. Brita nuk njihte lëshime ndjenjash, por në shtrat nuk bënte llafe. Ai trup bjond, i ngjeshur, i lëmuar, i zhdërvjellët, pa kurrfarë qime as edhe te nënbarku. Po, vërtet, ai në përgjithësi nuk i duronte dot bjondet, as edhe ato të rremet. Por Brita kishte kompaktësinë provokuese të një foke rioshe. Kur ngrinte krahët, sqetullat në ngjyrë rozë blatoheshin si lule me petale shpërvjelura, të lëmuara, të vakëta, pa kurrfarë hije, madje një fryrje e butë dukej paksa, aq e bollshme ishte shtatnjomësia.

I hodhi një sy tryezës së tij të shkrimit përsipër së cilës ishte një lëmsh librash, fashikujsh, letrash: shenjat e punës.

Në atë orë ishte piku i punës në qytet, lart, poshtë dhe përçark tij, në të njëjtin pallat njerëz si ai punonin, po ashtu në pallatin kundruall e në pallatin fare të vjetër të rrugës Fopa, që nëpërdukej në një shteg mes godinave, dhe akoma më pas, në pallatet e padukshme e ca më tej, ca më tej në mes të tymit, për kilometra e kilometra, punonin. Letra, regjistra, dosje, telefonata, dëftesa, duar që mbërthejnë pena, vegla, lapsa, duar që merren me një vidhë, me një mbërtheckë, me një shumëzim, me një shartim, me një saldim, me një llogari, me një ngjitje, shfarosje milingonash të etura nga mirëqenia e megjithatë mendimet e tyre - oh, i vinte për të qeshur, gjithçka rreth e rrotull, për shumë e shumë kilometra që u përmendën më lart, përsiatje të ngjashme me të tija, të fëlliqura e delikate, për atë zërin e mistershëm që hedh kushtrimin për shumimin

e species, e shthurur në vese të çuditshme e përvëluese, përse vallë askush nuk kishte kurajë ta thoshte? përsiatje rreth saj, rreth saj, rreth asaj goje të veçantë, rreth atyre buzëve që sesi janë, rreth atij përvijimi muskujsh të tendosur, të butë e fluidë, në një harkim krejt ndryshe nga gjithë të tjerët, rreth një rrudhe, një plotësie, një harkimi, një nxehtësie, një lagështie, një vetëlëshimi, një fundosjeje, një humnere zhuritëse. Dhe gazetaret flisnin për acarimin sovjetik, për interpelancat në Dhomën e Deputetëve mbi çështjen e Alto Adige-s, për sigurinë e nenit rreth autonomisë së PSI-së, për zjarrin në kinemanë Flaka, për krizën e këshillit krahinor siçilian, ç'palaçollëqe çmendurake.

Ndezi cigaren e pestë. Ishte më këmbë, me eksitim të veçantë që i takonte, atij aq të ndjeshëm e të trembur ("Tonino jam, mirëdita zo..." "Ju qenkeni? U bë kohë që..."). Por ndihej mirë, kurrfarë pjese e trupit nuk i jepte siklet. Tërësisht i qetë, i fortë dhe i kthjellët. Në të vërtetë ishte një mëngjes si shumë të tjerë. Qielli jashtë vazhdonte të mbetej gri dhe i njëtrajtshëm. Por ai ndihej mirë e paq.

Orët e ardhshme nuk i rëndonin e as i shtinin kurrfarë frike ditët që pasonin. As e ardhmja e madhe. Telefoni heshte. Dorigo ishte i qetë, gjërat i venin mbarë. Veshur me një kostum të përhimë, këmishë të bardhë, kravatë njëngjyrëshe të kuqe në manushaqe, çorape gjithashtu të kuqe, këpucë të zeza, të punuara për merak, thua se...

Thua se gjithçka duhej të vazhdonte siç kishte vazhduar deri atëherë, deri atë ditë shkurti, që ishte një e martë dhe mbante datën 9. Gjithçka e sigurt dhe ogurbardhë për një borgjez në kulmin e jetës, të mençur, të shthurur, të pasur e fatlum.

Zonja Ermelina rrinte në katin e gjashtë të një pallati të madh pranë sheshit Misori. Ashensori ishte nga ata që dera u hapet automatikisht vetiu, por nganjëherë mbyllet papritmas. Njëherë Dorigon e kishte zënë si në çark, për një çast ishte trembur se mos e shtypte si kokërr arre, por në të vërtetë trysnia e dy valvolave nuk ishte kushedi çfarë.

Në derë nuk kishte pllakëz me emrin të shkruar përsipër. Në korridorin e madh shtruar me mermer nuk pipëtinte njeri. Por dera nuk mund të ngatërrohej pikërisht prej mungesës së pllakëzës, pasi të gjitha të tjerat e kishin.

Ndiente padurimin e vagullimtë, më mos po emocionin e rasteve të tilla. Ç'vajzë do t'i binte në pjesë? Ishte gjëja më e thjeshtë në botë - Dorigo e dinte - të shkatërroje kuptimin e takimeve të tilla. Ç'lezet ka të shkosh me një grua, kur dihet se ajo e bën vetëm e vetëm për paratë? Ç'kënaqësi mund të ndiente burri, përveç asaj fizike, aq e shpejtë e në fund të fundit aq e diskutueshme? Kundërshtimi i kahershëm.

E megjithatë, kënaqësia ekzistonte. Dhe fort e madhe. Gati e pagjasë madje. Jo vetëm për lodrat mishërore pak a shumë të përpunuara. Ishte tërë paraprija që e bënte të mrekullueshme.

Zonja Ermelina e çeli derën menjëherë. Ishte nga Rexho Emilia, e përzemërt, babaxhane, ende grua e bukur, me pamje familjare, pa asgjë të dyshimtë. Ta mbaje vesh kur fliste, mund të thojë me plot gojën se bënte punën e kodoshes vetëm e vetëm për të ndihur ato çupkat e gjora.

Ai s'kish hyrë ende mirë, kur ajo i pëshpëriti me atë çehre bashkëfajësie:

“Do ta shihni ç'njomëzake, do ta shihni (e uli edhe më zërin)... Kujdes pra, është e mitur... një balerinë, një balerinë e

teatrit La Scala." Dhe sakaq po e fuste në sallon.

Prostitucioni është i mrekullueshëm, mendonte Dorigo. Mizor, i pamëshirë, sa e sa femra rrënoheshin prej tij. Ama sa i mrekullueshëm! Nuk të bëhej të besoje sa mundësi të tilla mund të ekzistonin në botën e sotme, kaq të zymtë e të mbytur nga rregullat. Ëndrra e realizuar me një të prekur të shkopit magjik, për njëzet mijë lira.

Për njëzet mijë lira, shpesh edhe për më pak, të shtiesh në dorë, pa vështirësinë dhe rrezikun më të vogël, ca çupka të mrekullueshme që në jetën e zakonshme, jashtë lojës, do të kushtonin një mal kohe, mundimesh, parash dhe mandej, ndoshta në çastin e duhur, mund të përmbysnin gjithçka. Ndërsa këtu! Një telefonatë. Një copë rrugë me makinë, gjashtë kate me ashensor dhe ja ku nimfëza po e hiqte gjoksoren me buzën në gaz.

A kishte ndonjë të keqe në këtë mes? Dorigos nuk i mungonin skrupujt moralë. Por sado që e kishte shkoqitur gjatë, nuk e kishte gjetur dot pikën e dobët. Nëse të gjithë do të bënin si unë, do të ishte më mirë a më keq? - pyeste vetmevete. Dhe nuk e shihte gjëkundin dëmin e mundshëm.

E megjithatë, thellë-thellë kishte diçka të fëlliqtë. Prostitucioni ndoshta e ngashënjente pikërisht për absurditetin e vet mizor dhe të turpshëm. Gruaja, ndoshta për shkak të edukatës familjare, i ishte dukur gjithnjë një krijesë e huaj, me një grua nuk ia kishte dalë dot kurrë të kishte afërinë që kishte me shokët. Për të gruaja ishte gjithnjë krijesa e një bote tjetër, vagullimthi sipërore dhe e padeshifrueshme. Ideja që një vajzë tetëmbëdhjetëvjeçare, për të fituar pesëmbëdhjetë mijë lira, binte në shtrat pa e tjerë gjatë me një burrë që as e ka parë dhe as e ka njohur kurrë, dhe që e linte të gëzonte krejt trupin duke marrë pjesë me brofje epshore pak a shumë të shtira, kjo ide Dorigos i ngjallte një ndjenjë mosbesimi dhe kryengritjeje. Si të kishte në këtë mes diçka krejtësisht të gabuar.

Por nga ky mendim i ashpër dhe lëndues, nga kjo paaftësi për të pranuar, lindte dëshira. Një grua për së mbari, që do

NJËZETE NJË
TREGIME

Titulli i origjinalit
SESSANTA RACCONTI

Përktheu:
HASAN S. BREGU

*Tregimet nga numri 1 deri 9 (përfshirë)
i përkisnin vëllimit Shtatë lajmëtarët;
ato nga numri 10 deri 18, vëllimit Frikë në Skala;
ato nga numri 19 deri 36, vëllimit Shembja e Balivernës.*

1
SHTATË LAJMËTARËT

I nisur për të eksploruar mbretërinë e tim eti, nga dita në ditë po shkoj duke u larguar nga qyteti dhe lajmet, që më arrijnë, bëhen gjithmonë e më të rralla.

E kam filluar udhëtimin pak më shumë se tridhjetëvjeçar dhe kanë kaluar më shumë se tetë vjet, saktësisht tetë vjet, gjashtë muaj e pesëmbëdhjetë ditë, ecjeje të pandërprerë. Besoja në nisje, se në pak javë do t'i kisha arritur me lehtësi kufijtë e mbretërisë e, përkundrazi, kam vazhduar të takoj gjithmonë njerëz e vende të reja; dhe kudo njerëz, që flisnin po gjuhën time, që thoshin se ishin nënshtetas të mi.

Mendoj nganjëherë se busulla e gjeografit tim është çmendur dhe që duke besuar se po vazhdojmë drejt jugut, në realitet ndoshta jemi duke u rrotulluar rreth vetes, pa e rritur kurrë largësinë, e cila na ndan nga kryeqyteti; kjo mund ta shpjegonte arsyen pse nuk kemi mbërritur ende në kufirin e fundit.

Por më dendur më torturon dyshimi se ky kufi nuk ekziston, se mbretëria shtrihet pa asnjë cak dhe se sado që përparoj, kurrë nuk do të mundem të arrij në fund.

U vura për udhë kur tashmë isha më shumë se tridhjetë vjeç, tepër vonë ndoshta. Miqtë, vetë familjarët, e shpotitnin projektin tim si harxhim i kotë i viteve më të mira të jetës. Në realitet, pak prej besnikëve të mi pranuan për t'u nisur.

Ndonëse moskokëçarës - shumë më tepër nga sa jam tani! - u kujdesa që gjatë udhëtimit, të mund të lidhesha me të dashurit e mi dhe midis kalorësve të shoqërimit, zgjodha shtatë më të mirët, që të më shërbenin si lajmëtarë.

Besoja, i pavetëdijshëm, se shtatë ishin madje një teprim. Me kalimin e kohës e kuptova, përkundrazi, që ishin në mënyrë qesharake pak; dhe sigurisht, që asnjeri prej tyre nuk ra kurrë

i sëmurë, as ndeshi në cuba, as i rraskapiti kuajt. Që të shtatë më kanë shërbyer me një këmbëngulje e me një devotshmëri, që vështirë se do të arrij t'ua shpërblej ndonjëherë.

Për t'i dalluar me lehtësi u vura emra me inicialet sipas rendit alfabetik: Alesandro, Bartolomeo, Çiano, Domeniko, Etoe, Federiko, Gregorio.

I pamësuar me largimin nga shtëpia, dërgova aty të parin, Alesandron, që në mbrëmjen e ditës së dytë të udhëtimit, kur kishim përshkuar tashmë nja tetëdhjetë lega. Mbrëmjen e mëpasshme, për t'u siguruar për vazhdimësinë e lidhjeve, dërgova të dytin, pastaj të tretin, pastaj të katërtin, rresht në mënyrë të njëpasnjëshme, deri në mbrëmjen e tetë të udhëtimit, kur u nis Gregori. I pari nuk ishte kthyer ende.

Na arriti mbrëmjen e dhjetë, teksa ishim duke përgatitur kampin për natën, në një luginë të pabanuar. Mësova nga Alesandroja se shpejtësia e tij kishte qenë më e vogël sesa parashikimi; kisha menduar se duke ecur i veçuar, mbi shalën e një pitoku¹ shumë të mirë, ai mund të përshkonte, në të njëjtën kohë, një largësi dy herë sa tonën; kurse kishte mundur vetëm një herë e gjysmë; në një ditë, ndërsa ne përparonim me dyzet lega, ai përpinte gjashtëdhjetë, por jo më shumë.

Kështu ishte edhe për të tjerët. Bartolomeoja, i nisur për në qytet në mbrëmjen e tretë të udhëtimit, na arriti në të pesëmbëdhjetën; Çianoja, i nisur në të katërtën, u kthye vetëm në të njëzetën. Shumë shpejt vura re se mjaftonte t'i shumëzoje për pesë ditët e përdorura deri aty, për të mësuar se kur do të na kishte kapur lajmëtari.

Duke u larguar gjithmonë e më shumë nga kryeqyteti, rrugëtimi i lajmëtarëve bëhej çdo herë e më i gjatë. Pas pesëdhjetë ditësh udhëtimi, intervali i kohës midis arritjes së njërit lajmëtar dhe tjetrit filloi të zmadhohej në mënyrë të ndjeshme; ndërsa më parë shihja të arrinte në kamp njëri prej tyre në çdo pesë ditë, ky interval kohor u bë njëzet e pesë; zëri

¹ Kalë lufte.

i qytetit tim bëhej në mënyrë të tillë gjithmonë e më i mekur; javë të tëra kalonin pa pasur ndonjë lajm.

Pasi kishin kaluar gjashtë muaj - tashmë i kishim kapërcyer malet Fazanë - intervali kohor midis arritjes së njërit lajmëtar dhe tjetrit u rrit në katër muaj të mirë. Ata më sillnin tashmë lajme të largëta; zarfet më vinin të zhubravitura, nganjëherë me njolla lagështie, për shkak të netëve të kaluara përjashta nga ai që m'i sillte.

Vazhduam të ecnim akoma. Më kot përpiquesha të bindja veten se retë, që kalonin sipër meje, ishin të njëjta me ato të fëmijërisë sime, se qielli i qytetit të largët nuk ishte i ndryshëm nga kupola e kaltër, që më qëndronte përmbi kokë, se ajri ishte po ai, e njëjtë fryrja e erës, të njëjtë zërat e zogjve. Në të vërtetë, retë, qielli, ajri, erërat, zogjtë, më dukeshin gjëra të reja e të ndryshme; dhe unë ndihesha i huaj.

Përpara, përpara! Endacakë të takuar nëpër rrafshina më thoshin se kufijtë nuk ishin larg. Unë i nxisja njerëzit e mi të mos uleshin, i shuaja fjalët shkurajuese, që formoheshin mbi buzët e tyre. Kishin kaluar tashmë katër vjet nga nisja ime; ç'mundim i gjatë. Kryeqyteti, shtëpia ime, im atë, ishin bërë çuditërisht të largët, gati nuk besoja në ta. Njëzet muaj të mirë heshtjeje dhe vetmie kalonin në mes tani midis mbërritjes së njërit lajmëtar dhe tjetrit. Më sillnin letra të çuditshme të zverdhura nga koha dhe në to gjeja emra të harruar, shprehje për mua të pazakonta, ndjenja, që nuk arrija t'i kuptoja. Mëngjesin tjetër, pas një nate të vetme pushimi, ndërsa ne viheshim përsëri për udhë, lajmëtari nisej në drejtim të kundërt, duke çuar në qytet letrat, që unë prej shumë kohe kisha përgatitur.

Por kanë kaluar tetë vjet e gjysmë. Këtë mbrëmje po haja darkë vetëm në çadrën time, kur hyri Domenikoja, që arrinte ende të buzëqeshte, ndonëse çehreprishur e i rraskapitur nga lodhja. Nuk e kisha parë prej gati shtatë vjetësh. Për gjithë këtë periudhë të gjatë ai nuk kishte bërë gjë tjetër veçse kishte rendur, përmes lëndinash, pyjesh e shkretëtirash, duke ndërruar kushedi sa herë kalin, për të më sjellë atë pako me

zarfe, që deri tani nuk kam patur dëshirë ta hap. Tashmë ai ka shkuar të flejë dhe do të niset përsëri po nesër në agim.

Do të niset për të fundit herë. Në bllokun e xhepit kam llogaritur që nëse gjithçka do të shkojë mirë, unë duke vazhduar rrugën siç kam bërë deri tani dhe ai të tijën, nuk do të mundem ta shoh përsëri Domenikon veçse pas tridhjetë e katër vjetësh. Atëherë unë do të jem shtatëdhjetë e dy. Por po filloj të ndihem i lodhur dhe ka mundësi që vdekja të më marrë më parë. Kështu që nuk do të mundem kurrë më ta shoh përsëri.

Pas tridhjetë e katër vjetësh (madje më parë, shumë më parë) Domenikoja do të shquajë papritmas nga larg zjarret e fushimit tim dhe do të vrasë mendjen se përse vallë, ndërkohë, unë kam bërë kaq pak rrugë. Ashtu si këtë mbrëmje, lajmëtari i mirë do të hyjë në çadrën time me letrat e zverdhura nga koha, të mbushura me lajme absurde të një kohe tashmë të varrosur; por do të ndalet tek pragu, duke më parë të palëvizur shtrirë mbi shtrojë, dy ushtarë anash me pishtarë, i vdekur.

E, megjithatë, shko, Domeniko, e mos më thuaj se jam i pamëshirshëm! Çoi përshëndetjen time të fundit qytetit ku kam lindur. Ti je lidhja, që ka mbetur gjallë me botën, e cila dikur ishte edhe imja. Mesazhet më të fundit më kanë bërë të mësoj se shumë gjëra kanë ndryshuar, se im atë ka vdekur, se kurora i ka kaluar vëllait tim më të madh, se më quajnë të humbur, se kanë ndërtuar pallate të larta guri atje ku më parë ishin lisat, nën të cilët shkoja zakonisht për të luajtur. Por, megjithatë, është gjithmonë atdheu im i vjetër.

Ti je e vetmja lidhje me ta, Domeniko. Lajmëtari i pestë, Etoreja, që do të më arrijë, dashtë Zoti, pas një viti e tetë muajsh, nuk do të mund të niset përsëri, sepse nuk do të arrinte më në kohë për t' u kthyer. Pas teje heshtja, o Domeniko, veç në mos gjetsha, më në fund, kufijtë e shumëdëshiruar. Por sa më shumë eci, aq më shumë shkoj duke u bindur se nuk ekziston kufi.

Nuk ekziston, kam dyshim, kufi, të paktën në kuptimin, që ne jemi mësuar të mendojmë. Nuk ka mure të mëdhenj

ndarjeje, as lugina ndarëse, as male, që mbyllin kalimin. Ka të ngjarë se do ta kapërcej kufirin pa e vënë re fare, madje, dhe do të vazhdoj të shkoj përpara, pa e ditur.

Për këtë arsye kam ndërmend që Etoreja dhe lajmëtarët e tjerë pas tij, kur të më kenë arritur përsëri, nuk do ta marrin më rrugën e kryeqytetit, por do të nisen përpara, për të më paraprirë, me qëllim që të mundem ta marr vesh që më parë atë çka më pret.

Që prej disa kohësh, një ankth i pazakontë më ndizet përbrenda në mbrëmje, por nuk është më keqardhje për gëzimet e lëna, sikurse më ndodhte në kohët e para të udhëtimit; më së shumti është padurimi për të njohur tokat e panjohura, të cilave u drejtohem.

Duhet të vë në dukje - dhe këtë nuk ia kam besuar deri tani askujt - duhet të vë në dukje sesi nga dita në ditë, dora-dorës që përparoj drejt cakut të pagjasë, në qiell rrezaton një dritë e pazakontë, e cila kurrë nuk më është shfaqur, as edhe në ëndrra; dhe sesi bimët, malet, lumenjtë që përshkojmë, duken të bërë me një esencë të ndryshme nga ajo jona dhe ajri mbart parandjenja, që nuk di t'i them.

Një shpresë e re do të më tërheqë nesër në mëngjes edhe më përpara, drejt atyre maleve të paeksploruara, që hijet e natës janë duke i fshehur. Prapë edhe një herë do të ngre kampin, teksa Domenikoja do të humbasë në horizont nga ana e kundërt, për t'i çuar qytetit shumë të largët mesazhin tim të kotë.

2

SULMI NDAJ KARVANIT TË MADH

I arrestuar në një rrugë të fshatit dhe i dënuar vetëm për kontrabandë - pasi nuk e kishin njohur - Gaspare Planeta, kryekusari, qëndroi tre vjet në burg.

Doli prej andej i ndryshuar. Sëmundja e kishte tretur, i ishte rritur mjekra, ngjante më shumë si një plakarush dhe jo si kryekusari i famshëm, më i miri pushkatar i njohur, që nuk dinte të gabonte një të shtënë.

Atëherë, me plaçkat në një thes, u vu në rrugë për Monte Fumo, që kishte qenë mbretëria e tij, ku kishin mbetur shokët.

Ishte një e diel qershori, kur u fut nëpër luginën, në fund të së cilës ndodhej shtëpia e tyre. Shtigjet e pyllit nuk kishin ndryshuar: këtu një rrënjë e dalë në sipërfaqe, atje një gur karakteristik, që ai e kujtonte mirë. Gjithçka si më parë.

Meqë ishte ditë pushimi, kusarët ishin mbledhur në shtëpi. Duke u afruar, Planeta dëgjoi zëra e të qeshura. Në kundërshtim me zakonet e kohërave të tij, dera ishte e mbyllur.

Trokiti dy-tri herë. Brenda u bë heshtje. Pastaj pyetën:

- Kush është?

- Vij nga qyteti, - u përgjigj ai, - vij nga ana e Planetës.

Donte t' u bënte një të papritur, por përkundrazi, kur ia hapën derën dhe i dolën përpara, Gaspare Planeta e kuptoi menjëherë se nuk e kishin njohur. Vetëm qeni plak i shoqërisë, Tromba kockë e lëkurë, iu hodh përsipër me hungërima gëzimi.

Në fillim, shokët e tij të vjetër, Kozimoja, Markoja, Felpa dhe edhe tre-katër fytyra të reja, iu mblodhën përreth, duke

i kërkuar lajme për Planetën. Ai u tregoi se e kishte njohur kryekusarin në burg; tha se Planeta do të lirohej pas një muaji dhe ndërkaq, kishte dërguar atë aty lart, për të mësuar sesi shkonin punët.

Megjithatë, pas pak kusarët e humbën interesin për të sapoardhurin dhe gjetën pretekste për ta lënë vetëm. Vetëm Kozimoja qëndroi të fliste me të, edhe pse duke mos e njohur.

- Dhe kur të kthehet çfarë ka ndërmend të bëjë? - pyeste, duke e hedhur fjalën për kapon e vjetër, që ishte në burg.

- Çfarë ka ndërmend të bëjë? - përsëriti Planeta - Ndoshta pse nuk mund të kthehet këtu?

- Ah, po, po, unë nuk them asgjë. Mendoja për atë, mendoja. Gjërat këtu kanë ndryshuar. Dhe ai do të kërkojë të komandojë prapë, kuptohet, por nuk e di...

- Nuk di çfarë?

- Nuk e di nëse Andrea do të jetë i gatshëm... do të krijojë sigurisht probleme... Për mua le të kthehet, përkundrazi, ne të dy gjithmonë kemi shkuar mirë...

Gaspere Planeta mësoi kështu se kapoja i ri ishte Andrea, njëri prej shokëve të tij të dikurshëm, ai që madje dukej atëherë më kafsha.

Në atë çast u hap dera kat më kat, duke lënë të hynte pikërisht Andrea, që ndaloi në mes të dhomës. Planeta sillte ndërmend një stërhell apatik. Tani i qëndronte përpara një goxha kusar i frikshëm, me një fytyrë të ashpër dhe me një palë mustaqe të shkëlqyera.

Kur mësoi për të sapoardhurin, që edhe ai nuk e njohu, tha në lidhje me Planetën:

- Ah, ashtu? Por si vallë nuk ia ka dalë të arratiset? Nuk duhet të jetë, megjithatë, aq e vështirë. Markon, edhe atë e futën brenda, por nuk qëndroi atje veçse gjashtë ditë. Edhe Stelës nuk iu desh shumë, për t'u arratisur. Dhe pikërisht ai, që ishte kapoja, pikërisht ai, nuk ka bërë një figurë të bukur.

- Nuk është më si dikur, si të thuash, - tha Planeta me

një buzëqeshje dinake. - Ka shumë roje tani, hekurat i kanë ndërruar, nuk na linin kurrë vetëm. Dhe, pastaj, ai është i sëmurë.

Kështu tha; por ndërkaq e kuptonte se kishte mbetur jashtë, e kuptonte se një kryekusar nuk mund ta lërë veten të burgoset, aq më pak të qëndrojë brenda tre vjet si një fatkeq çfarëdo, e kuptonte që ishte i vjetër, se për të nuk kishte më vend, se koha e tij kishte perënduar.

- Më tha, - nisi përsëri me zë të lodhur ai, zakonisht gazmor e i qetë, - Planeta më tha se ka lënë këtu kalin e tij, një kalë të bardhë, thoshte, që quhet Polak, më duket, dhe ka një ënjtje nën njërin gju.

- E kishte, do të thuash e kishte, - tha Andrea arrogant, duke filluar të dyshojë se ishte pikërisht Planeta i pranishëm. - Nëse kali ka ngordhur, faji nuk do të jetë yni...

- Më tha, - vazhdoi i qetë Planeta, - se kishte lënë këtu ca rroba, një fener, një sahat.

Dhe buzëqeshte ndërkaq me majë të buzëve e i afrohej dritares, në mënyrë që të gjithë të mundeshin ta shihnin mirë.

Dhe të gjithë, në fakt, e panë mirë, njohën tek ai plakush kockë e lëkurë atë ç'ka kishte mbetur prej kapos së tyre, prej të famshmit Gaspere Planeta, prej më të mirit pushkatar të njohur, që nuk dinte të gabonte një të shtënë.

E, megjithatë, askush nuk pipëtiu. Edhe Kozimoja nuk guxoi të thoshte asgjë. Të gjithë u shtirën sikur nuk e kishin njohur, sepse ishte i pranishëm Andrea, kapoja i ri, prej të cilit kishin frikë. Edhe Andrea ishte shtirur sikur s'kishte kuptuar asgjë.

- Gjërat e tij askush s'i ka prekur, - tha Andrea, - duhet të jenë atje në një sirtar. Për rrobat nuk di asgjë. Ka të ngjarë t'i ketë përdorur ndonjë tjetër.

- Më tha, - vazhdoi gjakftohtë Planeta, këtë herë pa buzëqeshur më, - më tha se ka lënë këtu pushkën e tij, pushkën e tij me precizion.

- Pushka e tij është gjithmonë këtu, - tha Andrea, - dhe

mund të vijë ta marrë.

- Më thoshte, - vazhdoi Planeta, - më thoshte gjithmonë, kushedi si do të ma përdorin, pushkën time, kushedi çfarë hekurishteje do të gjej kur të kthehem. E donte shumë pushkën e tij.

- E kam përdorur unë ndonjë herë, - pohoi Andrea me një ton të lehtë sfide, - por nuk besoj ta kem ngrënë.

Gaspare Planeta u ul mbi një stol. Ndiante në trup ethet e tij të zakonshme, jo ndonjë gjë e madhe, por aq sa duhet, për t'ia bërë kokën të rëndë.

- Thuamë, - tha drejtuar Andreas, - a mundem ta shoh?

- Hajde, - u përgjigj Andrea, duke i bërë shenjë njërit prej kusarëve të rinj, që Planeta nuk e njihte, - hajde, shko matanë ta marrësh.

Ia sollën Planetës pushkën. Ai e vrojtoi fill e për pe me pamje të shqetësuar dhe dora-dorës, u duk se po qetësohej. E ledhatoi tytën me duar.

- Mirë, - tha pas një pauze të gjatë, - dhe më tha edhe se kishte lënë këtu municione. Më kujtohet madje saktësisht: barat, gjashtë masa, dhe tetëdhjetë e pesë plumba.

- Hajde, - tha Andrea me pamje të bezdisur, - hajde, shkoni t'ia merrni. Dhe, mandej, ka ndonjë gjë tjetër?

- Mandej është kjo, - tha Planeta me qetësinë më të madhe, duke u ngritur nga stoli, duke iu afrua Andreas e duke i shkëputur nga rripi kamën e gjatë të futur në mill. - Është edhe kjo, - theksoi, - thika e tij e gjahut. - Dhe u kthye të ulej.

Pasoi një heshtje e gjatë, e rëndë. Më në fund, ishte Andrea që foli:

- Eh, natën e mirë, - tha, për t'i dhënë të kuptonte Planetës se mund të shkonte tashmë.

Gaspare Planeta ngrii sytë, duke matur trupin e fuqishëm të Andreas. Do të kishte mundur vallë ta sfidonte, i vuajtur e i këputur siç ndihej? Prandaj, u ngrit ngadalë, priti që t'i jepnin edhe gjërat e tij të tjera, i futi të gjitha në thes, e hodhi pushkën në sup.

- Atëherë, natën e mirë, zotërinj, - tha, duke u nisur drejt derës.

Kusarët mbetën të heshtur, të palëvizur prej shtangies nga habia, sepse kurrë nuk do ta kishin imagjinuar që Gaspare Planeta, kryekusari i famshëm, mund të largohej ashtu, duke e lënë veten të poshtërohej në atë mënyrë. Vetëm Kozimoja gjeti një fije zëri, një zë çuditërisht të mekur.

- Lamtumirë, Planeta! - thirri, duke lënë mënjanë çdo shtirje.
- Lamtumirë, paç fat!

Planeta u largua nëpër pyll, në mes të hijeve të mbrëmjes, duke fishkëllyer një melodi të gëzuar.

Kështu ndodhi me Planetën, tani jo më kryekusar, por vetëm Gaspare Planeta, bir i të ndjerit Severino, vjeç 48, pa vendbanim të përhershëm. Megjithatë, një banesë e kishte, një kasolle të vetën në Monte Fumo, gjysmë druri e gjysmë guri, në mes të shkurnajave, ku strehohej dikur kur kishte tepër roje rreth e rrotull.

Planeta mbërriti tek kasollja e tij, ndezi zjarrin, numëroi paratë që kishte (mund t'i mjaftonin për ndonjë muaj) dhe filloi të jetonte vetëm.

Por një mbrëmje, kur ishte ulur pranë zjarrit, u hap papritmas dera dhe u shfaq një i ri, me një pushkë. Do të ishte nja shtatëmbëdhjetë vjeç.

- Ç'është? - pyeti Planeta, pa u ngritur madje as në këmbë.

I riu kishte një pamje të guximshme, i ngjante atij, Planetës, nja tridhjetë vjet më parë.

- Janë këtu ata të Monte Fumos? U bënë tri ditë që jam në kërkim.

Djaloshi quhej Pietro. Tregoi pa ngurrim se dëshironte të bashkohej me kusarët. Kishte jetuar gjithmonë si endacak dhe kishte vite që mendohej për këtë, por për t'u bërë kusar duhej të paktën një pushkë dhe i ishte dashur të priste goxha kohë, por tani e kishte vjedhur një, madje një pushkë mjaft të mirë me fitil.

- Ke rënë tamam, - tha Planeta gëzueshëm, - unë jam Planeta.

- Planeta kapoja, do të thuash?

- Po, sigurisht, pikërisht ai.

- Po a nuk ishte në burg?

- Kam qenë, si të thuash, - shpjegoi dhëlpërisht Planeta. - Kam qenë tri ditë. Nuk arritën dot të më mbajnë më shumë.

Djaloshi e vështroi me entuziazëm.

- Po atëherë, dëshiron të më marrësh me vete?

- Të të marrë me vete? - tha Planeta. - Eh, për këtë natë fli këtu, pastaj nesër do të shohim.

Të dy jetuan së bashku. Planeta nuk e zhgënjeu djalosin, e la të besonte se ishte gjithmonë ai kapoja, i shpjegoi se parapëlqente që të jetonte vetëm dhe të takohej me shokët vetëm kur ishte e nevojshme. Djaloshi e besoi të fuqishëm dhe priti nga ai gjëra të mëdha.

Por kalonin ditët dhe Planeta nuk lëvizte. Shumë-shumë, sillej një çikë rreth e rrotull për të gjuajtur. Për pjesën tjetër, qëndronte gjithmonë pranë zjarrit.

- Kapo, - thoshte Pietroja, - kur do të më marrësh me vete për të bërë diçka?

- Ah, - përgjigjej Planeta, - në ndonjë nga këto ditë do ta organizojmë mirë. Do të urdhëroj të vijnë të gjithë shokët, do të kesh rast të kënaqesh.

Por ditët vazhdonin të kalonin.

- Kapo, - thoshte djaloshi, - mora vesh se nesër, poshtë në rrugën e luginës, nesër kalon me karrocë një tregtar, një farë zoti Françesko, që duhet t'i ketë xhepat plot.

- Një farë Françesko? - thoshte Planeta, pa treguar interes. - Gjynah, pikërisht ai, e njoh mirë prej goxha kohe. Një dhëlpër e hatashme, por të them se, kur vihet për udhë, nuk merr me vete as edhe një skud, është shumë nëse mban edhe rroba veshur, nga frika se ka hajdutë.

- Kapo, - thoshte djaloshi, - mora vesh se nesër kalojnë dy karro me mall të mirë, krejt mallra për të ngrënë, ç' thua,

Kapo?

- Me të vërtetë? - thoshte Planeta. - Mallra për të ngrënë? - dhe e linte me shpërfillje, sikur kjo gjë të mos ishte e denjë për të.

- Kapo, - thoshte djaloshi, - nesër është festa në fshat, ka një mori me njerëz që vërtiten, do të kalojnë shumë karroca, shumë do të kthehen edhe natën. A nuk do të ishte e përshtatshme për të bërë diçka?

- Kur ka njerëz shumë, - përgjigjej Planeta, - është më mirë ta lësh atë punë. Kur ka festë, sillen rrotull xhandarët. Nuk ia vlen barra qiranë t'i besosh. Ndodhi pikërisht në një ditë të tillë që më kapën.

- Kapo, - thoshte pas disa ditësh djaloshi, - thuaj të vërtetën, ti ke diçka. Nuk ke më dëshirë të lëvizësh. As edhe për gjah nuk dëshiron më të vish. Shokët nuk dëshiron t'i shohësh. Ti duhet të jesh i sëmurë, edhe dje duhej të kishe ethe, rri gjithmonë i ngjitur pas zjarrit. Përse nuk më flet qartë?

- Mundet që unë të mos jem mirë, - thoshte Planeta, duke buzëqeshur, - por nuk është siç mendon ti. Nëse dëshiron vërtet që të ta them, më pas të paktën do të më lësh të qetë, është budallallëk të punosh si kalë për të fituar ndonjë napolon. Nëse lëviz, dua që t'ia vlejë mundimi. Mirë, kam vendosur, si të thuash, të pres Karvanin e Madh.

Donte të thoshte Karvanin e Madh, që një herë në vit, saktësisht më 12 shtator, çonte në kryeqytet një ngarkesë ari, të gjitha taksat e provincave të jugut. Shkonte përpara në mes të tingujve të brirëve, gjatë rrugës kryesore, midis çukërmimit të kuajve të gardës së armatosur. Karvani i Madh perandorak, me karron e madhe të hekurt, e gjitha plot me monedha, të mbyllura në thasë të vegjël të panumërt. Kusarët e ëndërronin në netët e mira, por që prej njëqind vjetësh askush nuk kishte arritur ta sulmonte pa u ndëshkuar. Trembëdhjetë kusarë kishin vdekur, njëzet të futur në burg. Askush nuk guxonte të mendonte më për të; nga viti në vit, mandej, e ardhura e taksave rritej dhe shtohet eskorta e armatosur e shoqërimit.

Kalorës të lehtë përpara e prapa, patrulla me kuaj anash, të armatosur karrocierët, kujdestarët e kuajve dhe shërbëtorët.

Paraprinte një lloj stafete, me trombë e flamur. Në një farë largësie, pasonin njëzet e katër kalorës të lehtë, me pushkë, pistoleta e shpata. Pastaj vinte karroja e hekurt, me stemën perandorake në relief, e tërhequr nga gjashtëmbëdhjetë kuaj. Njëzet e katër kalorës të lehtë, edhe prapa, dymbëdhjetë të tjerë nga të dyja anët. Njëqind mijë dukatë të artë, njëmijë onçë argjendi, të rezervuar për arkën perandorake. Hyr e dil nëpër lugina, karvani përrallor kalonte me galop të shpejtë. Luka Toro, njëqind vjet më parë, kishte patur guximin ta sulmonte dhe i kishte shkuar mrekullisht mirë. Ishte ajo hera e parë: eskorta e shoqërimit kishte marrë frikë. Luka Toro ishte arratisur mandej në Lindje dhe kishte zënë të sillej si zotëri.

Në largësinë e shumë viteve, edhe kusarë të tjerë kishin provuar: Xhovani Borso, për të përmendur vetëm disa, Gjermani, Serxho i Minjve, Konti dhe Kapoja i tridhjetë e tetëve. Të gjithë, mëngjesin e mëpasshëm, të shtrirë në buzë të rrugës, me kokën të çarë.

- Karvanin e Madh? Do të rrezikosh seriozisht? - pyeti djaloshi i mrekulluar.

- Po, sigurisht, dua të rrezikoj. Nëse ia arrij, rregullohem përgjithmonë.

Kështu tha Gaspere Planeta, por thellë në shpirtin e tij as që e mendonte. Do të kishte qenë një çmenduri e plotë, edhe sikur të ishin nja njëzet vetë, të sulmoje Karvanin e Madh. Merre me mend pastaj vetëm!

E kishte thënë ashtu për shaka, por djaloshi e mori seriozisht dhe e vështroi Planetën me admirim.

- Thuamë, - tha djaloshi, - e sa do të jeni?

- Nja pesëmbëdhjetë, të paktën, do të jemi.

- E kur?

- Ka kohë, - u përgjigj Planeta, - duhet t'ua kërkoj shokëve. Nuk është aspak për të bërë shaka.

Por ditët, sikurse ndodh, nuk e patën të vështirë të kalonin